

FORMULARI I ANKESËS PRANË AUTORITETIT/ENTIT KONTRAKTOR DHE
KOMISIONIT TË PROKURIMIT PUBLIK

Ankesë drejtuar: Autoriteti/Entit Kontraktor: Njësia Vendore e Kujdesit Shëndetësor Tiranë.

Ankesë drejtuar: Komisionit të Prokurimit Publik .

Seksioni I. Identifikimi i ankimuesit

Ankimuesi mund të jetë një ofertues ose ofertues i mundshëm (p.sh. individ, operator ekonomik, shoqatë, bashkim operatorësh ekonomike)

Avdul Gjoni Person Fizik

Emri i plotë i ankimuesit (ju lutem shtypeni)

M18929501J

Nuis/Nipt

Lagjia "Selam Musai", Rruga "Dule Dalani", ZK 3574, Nr. pasurie 56, godinë 1- katëshe.

Adresa

Tepelenë

Shqipëri

Qyteti

Shteti

Kodi Postar / Posta

+355683169924

Numri i telefonit (përfshirë kodin e zonës)

Numri i faksit (përfshirë kodin e zonës)

avdulgjoni@yahoo.com

E-mail

Avdul Gjoni Person Fizik

Emri dhe titulli i zyrtarit të autorizuar për lëshimin e ankesës (ju lutemi shkruani)

2023/12/11

Nënshkrimi i zyrtarit të autorizuar

Data (viti/muaji/dita)

+355683169924

Numri i telefonit (përfshirë kodin e zonës)

Numri i faksit (përfshirë kodin e zonës)

Seksioni II. Informacion mbi procedurën

1. Numri i referencës së procedurës/Lotit

Plotësoni numrin e referencës së kontratës në njoftimin e kontratës ose në dokumentet e tenderit.
REF-89520-12-04-2023

2. Lloji i Procedurës

Plotësoni llojin e procedurës së përdorur për prokurimin në fjalë.

Procedurë e hapur	<input type="checkbox"/>	Procedurë e hapur e thjeshtuar	X
Procedurë e kufizuar	<input type="checkbox"/>	Procedurë konkurruese me negociim	<input type="checkbox"/>
Partneritet për inovacion	<input type="checkbox"/>	Dialog konkurrues	<input type="checkbox"/>
Procedurë me negociim me shpallje paraprake të njoftimit	<input type="checkbox"/>	Procedurë me negociim pa shpallje paraprake të njoftimit të kontratës	<input type="checkbox"/>
Shërbim Konsulence	<input type="checkbox"/>		
Kontratë e lidhur pa zhvilluar ndonjë nga procedurat e prokurimit të parashikuara në LPP	<input type="checkbox"/>		

3. Autoriteti /Enti Kontraktor

Emri i autoritetit/entit kontraktor që administron procesin e prokurimit.

Njësia Vendore e Kujdesit Shendetësor Tiranë

4. Vlera e përlogaritur e prokurimit

(Vlera e përlogaritur e kontratës/marrëveshjes kuadër) (shuma në shifra dhe fjalë)

7 992 867 (shtatë milion e nëntëqind e nëntëdhjetë e dy mijë e tetëqind gjashtëdhjetë e shtatë) Lekë pa TVSH

5. Objekti i kontratës/Marreveshjes Kuadër

(Përshkrimi i shkurtër i punëve / mallrave / shërbimeve objekt kontrate/marreveshje kuader).

Blerje Kite dhe Reagentë, për nevojat e NJVKSH Tirane

6. Afati i fundit për paraqitjen e ofertës

(Data (viti/muaji/dita)

2023/12/15



7. Data e publikimit të Njoftimit të Fituesit
(Data (viti/muaji/dita) nëse është e zbatueshme)

8. Data e nënshkrimit të kontratës

(Data (viti/muaji/dita) në rastet e kërkesave për pavlefshmërinë e kontratës)

Seksioni III. Përshkrimi i ankesës

1. Baza ligjore (Shkelje ligjore, bazuar në vendime, akte, dokumente, etj.)

Hartimi i DT është bërë në kundërshtim me Ligjin e Prokurimit Publik dhe Rregullat e Prokurimit Publik.

2. Objekti i ankesës

- Modifikim i dokumentave të tenderit

X

- Kundërshtim i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave lidhur me skualifikimin e ofertës tuaj.

(Citoni këtu arsyet e skualifikimit)

- Kundërshtim i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave lidhur me kualifikimin e ofertës të një/disa operatori/ve ekonomik pjesëmarrës në procedurën e prokurimit.

(Citoni operatorin/ët ekonomik për të cilin keni pretendime)

- Pavlefshmëri kontrate

(Citoni kontratën për të cilën kërkon pavlefshmërinë)

- Tjetër

(Citoni këtu objektin e ankesës që nuk përfshihet më sipër)

3. Rrethanat dhe faktet

Përshkruani rrethanat e faktit.

Njësia e hartimit të DT ka vendosur kritere kualifikimi të kundraligjshme të cilat kufizojnë konkurrencën e lirë dhe paracaktojnë fituesin e kësaj procedure.

4. Argumentime mbi shkeljet e pretenduara

Përshkruani në mënyrë koncize shkeljet e pretenduara, duke argumentuar qartë dhe saktë se përse pretendoni për paligjshmëri në veprimet e autoritetit kontraktor.



Pasi u njohëm me DT të procedurës së prokurimit me objekt “Blerje Kite dhe Reagentë, për nevojat e NJVKSH Tirane” konstatuam disa kriteret kualifikimi jo të rregullta.

Bazuar në nenin 110 të Ligjit nr. 162/2020 datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik” dhe nenin 97 të V.K.M. nr. 285 datë 19.05.2021 “Për Rregullat e Prokurimit Publik” i ndryshuar po paraqesim këtë formular ankese duke kërkuar modifikimin e kriterëve të kualifikimit.

Në pikën 2.8 të dokumentave të tenderit është shprehur që:

2.8 Kushtet që duhet të zbatohen në rastin e rihapjes së konkurrimit:

	<i>Nuk do të ketë rihapje të konkursit. Kontratat do të lidhen sipas kërkesave të AK, me operatorin ekonomik më të suksesshëm, i cili do të ofrojë çmimin më të ulët për njësi për artikujt objekt prokurimi dhe vlerën e pritshme më të ulët</i>
--	---------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------

2.10 Përshkrimi i shkurtër i kontratës / Marrëveshjes Kuadër

1. Fondi limit/vlera e pritshme e kontratave: 7 992 867 (shtatë milion e nëntëqind e nëntëdhjetë e dy mijë e tetëqind gjashtëdhjetë e shtatë) **Lekë pa TVSH**

2. Në rastin kur, objekti i prokurimit përbëhet nga disa artikuj, **Shumatorja e çmimeve për njësi është: 284,870 (dyqind e tetëdhjetë e katër mijë e tetëqind e shtatëdhjetë) lekë pa tvsh**

Sqarim: Në mbështetje të VKM-së Nr 285 dt 19.05.2021 për “Miratimin e rregullave të prokurimit publik” (i ndryshuar), Neni 62 pika 5 ofertimi i operatorëve ekonomikë do të bëhet me çmim për njësi dhe për efekt krahasimi edhe vlerësimi i ofertave të paraqitura do të bëhet mbi bazën e shumatores së çmimeve për njësi të përllogaritur për cdo artikull/zë.

4.4 Kriteret e përzgjedhjes së fituesit:

A) **Oferta ekonomikisht më e favorshme, bazuar në kosto**

Sipas rëndësisë:

çmimi pikët

_____ pikët

_____ pikët

_____ pikët

Autoriteti/ Enti Kontraktor duhet të specifikojë pikët për secilin kriter të përcaktuar të vlerësimit.

OSE

B) **oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në çmim X**

Në rastin e marrëveshjes kuadër, kur do të përdoret kriteri i vlerësimit të çmimit për njësi, për qëllime krahasimi, vlerësimi i ofertave të paraqitura do të bëhet në bazë të shumatores së çmimeve për njësi. Në mbështetje të VKM-së Nr 285 dt 19.05.2021 për “Miratimin e rregullave të prokurimit publik” (i ndryshuar), Neni 62, pika 5, ofertimi i operatorëve ekonomikë do të bëhet me çmim për njësi dhe për efekt krahasimi edhe vlerësimi i ofertave të paraqitura do të bëhet mbi bazën e shumatores së çmimeve për njësi të përllogaritur për cdo artikull/zë.



***Kujdes*:** Vlera e pritshme e kontratave nuk duhet të kalojë fondin limit të shpallur në këto Dokumente Tenderi. Në të kundërt oferta do të refuzohet.*

Është detyrë e Njesisë së Hartimit të Dokumentave të Tenderit hartimi i tyre në përputhje me LPP dhe RrPP duke dhënë informacion të saktë për operatorët ekonomikë. Duke qënë se në DT është e paqartë mënyra se si duhet të ofertojnë OE kërkojmë sqarime nëse vlerësimi i ofertave do të bëhet bazuar në shumatoren e çmimeve për njësi apo bazuar në çmimin total!?

Në shtojcën 6, **FORMULARI I SASISË DHE GRAFIKUT TË LËVRIMIT,**

Sasia e mallit që kërkohet:

Afatet e lëvrimit:

Për cdo kontratë të lidhur sipas përcaktimit më sipër afatet e lëvrimit do të jenë si më poshtë:

-40% e mallit për materialet kite, reagentë, konsumabël etj., duhet të lëvrohet maksimumi brenda 30 ditëve pas nënshkrimit të kontratës

-pjesa tjetër sipas kërkesave të Autoritetit Kontraktor

Duke qënë se Operatorët Ekonomikë në këtë procedurë janë vetëm importues të këtyre materialeve dhe jo prodhues, pasi në total janë 78 artikuj nga minimumi 10 kompani prodhuese të ndryshme, ku shumica e këtyre artikujve nuk mund të mbahen stok, afati i lëvrimit prej 30 ditëve pas nënshkrimit të kontratës është e pamundur për tu plotësuar nga Operatorët Ekonomikë të interesuar. Aq më tepër duke qënë në muajin Dhjetor, që është fundvit dhe është prag festash, të gjitha kompanitë si prodhuese, ashtu dhe distributore janë të mbyllura dhe po ashtu shumica e tyre kanë mbyllur dhe porositë e transportit deri nga java e dytë e Janarit.

Sa më sispër kërkojmë që për pikën e parë të rritet afati i lëvrimit nga 30 ditë, në 60 ditë.

Ndërsa për pikën e dytë ku AK shprehet që **“pjesa tjetër sipas kërkesave të Autoritetit Kontraktor” kërkojmë** të sqarohet gjithashtu afati i lëvrimit, pasi AK nuk mund ti kërkojë materialet sot për nesër por duhet të caktohet një periudhë kohore e arsyeshme ndërmjet kërkesës së AK dhe furnizimit.

Kërkojmë që kjo pikë të ndryshohet në **“pjesa tjetër sipas kërkesave të Autoritetit Kontraktor por jo më shumë se 45 ditë”**


Në dokumentat e tenderit është kërkuar: **2.3 Kapaciteti teknik:**

a. *Operatori ekonomik duhet te paraqese dëshmi për furnizimet e mëparshme, të ngjashme me objektin e prokurimit, të kryera gjatë tri viteve të fundit nga data e shpalljes të njoftimit të kontratës, me një vlerë jo më të vogël se 40% e vlerës së përllogaritur të kontratës që prokurohet.*

- *Si dëshmi për përvojën e mëparshme me nje ent publik, kërkohen vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratën ose/dhe fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.*

- *Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, si dëshmi pranohen vetëm fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.*

Në nenin 40, pika 4 **“Kërkesa të veçanta për kontratat e mallrave”** të M.K.M Nr. 285 datë 19.05.2021 **“Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”,** i ndryshuar parashikohet se: **“Për të provuar përvojën e mëparshme, autoriteti/enti kontraktor kërkon dëshmi për realizimin me sukses të një ose disa kontratave të**



mëparshme, të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit. Në çdo rast, vlera totale e kërkuar duhet të jetë në një vlerë jo më të madhe se 40% të vlerës së përlllogaritur të kontratës, që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tre viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.

Autoriteti/enti kontraktor si dëshmi për përvojën e mëparshme kërkon vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës ose/dhe fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, si dëshmi pranohen vetëm fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.”

Sa më sipër kërkojmë modifikimin e këtij kriter duke u bazuar në ligjin në fuqi.

Në dokumentat e tenderit është kërkuar:

c. Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë **Autorizim të lëshuar nga Prodhuesi / MAH / Distributori Zyrtar i Autorizuar** (ku të provohet /dokumentohet lidhja e tyre me prodhuesin) nëpërmjet te cilit konfirmohet se autorizohet të tregtojë mallrat (materialet mjekësore) objekt prokurimi. Autorizimi duhet të jete i vlefshëm në momentin e hapjes dhe dorëzimit të ofertave.

Shënim: Kriterin e mësipërm, ofertuesit mund ta përmbushin edhe në formë vetëdeklarimi, me kusht që në rastin e renditjes i pari, me njoftimin e paraqitjes së dokumentacionit pranë AK dhe përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, duhet të dorëzojë dokumentet provuese për deklarimin e bërë. Mosparaqitja e këtij dokumentacioni përbën kusht për skualifikimin e ofertës së paraqitur. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin.

Duke qenë se e kemi vendosur këtë kriter në vite dhe ky kriter gjen mbështetje në pikat 2 dhe 4 të nenit 77 të Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe pikën 5 të nenit 44 të VKM nr. 285 datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, ku është e cituar: 5. Kur është e dukshme që një operator ekonomik e ka të pamundur të marrë etiketën specifike, të cilësuar nga autoriteti/enti kontraktor ose një etiketë ekuivalente, brenda afateve kohore përkatëse, për shkaqe që nuk lidhen me atë operator ekonomik, autoriteti ose enti kontraktor pranon mënyra të tjera vërtetimi të përshtatshme, që mund të përfshijnë një dosje teknike nga prodhuesi, nëse operatori ekonomik në fjalë vërteton se punët, furnizimet ose shërbimet që ai duhet të ofrojë përmbushin kërkesat e etiketës specifike ose kërkesat specifike të cilësuar nga autoriteti/enti kontraktor., si dhe pikën 8 të nenit 40 ‘Kërkesa të veçanta për kontratat e mallrave’ ku parashikohet se: 8. Autoriteti/enti kontraktor, përveç kërkesave të parashikuara në këtë nen, mund të përcaktojë kritere të tjera të veçanta, në varësi të objektit që prokurohet, të cilat i vlerëson të nevojshme për ekzekutimin me sukses të kontratës, kërkojmë nga ana juaj që të hiqet ”**Shënim:** Kriterin e mësipërm, ofertuesit mund ta përmbushin edhe në formë vetëdeklarimi, me kusht që në rastin e renditjes i pari, me njoftimin e paraqitjes së dokumentacionit pranë AK dhe përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, duhet të dorëzojë dokumentet provuese për deklarimin e bërë. Mosparaqitja e këtij dokumentacioni përbën kusht për skualifikimin e ofertës së paraqitur. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin.” dhe autorizimi për prodhuesin ose distributorin e autorizuar nga prodhuesi (ku të provohet /dokumentohet lidhja e tyre me prodhuesin) të dorëzohet në ditën dhe orën e hapjes të ofertave, përderisa edhe kërkohet që të jetë i vlefshëm në momentin e hapjes dhe dorëzimit të ofertave, në mënyrë që të shmangen abuzimet e mundshme në vlerësimin objektiv të ofertave dhe shpalljen e fituesit.

Për më tepër që Ligji ka përcaktuar se cilat janë dokumentat për të cilat plotësohet vetdeklarimi të cilat duhet të paraqiten nga OE fitues dhe autorizimi i prodhuesit/distributorit nuk përfshihet në këtë listë.



8

Në shtojcën 5 të dokumenteve të tenderit është përcaktuar:

56	<i>N-naftiletilendiamin</i>	<i>C12H14N2, Pure</i>	<i>Gram</i>
----	-----------------------------	-----------------------	-------------

Është detyrë e Njesisë së Hartimit të Dokumentave të Tenderit hartimi i tyre në përputhje me LPP dhe RrPP duke dhënë informacion të saktë për operatorët ekonomikë. Kërkojmë të sqarohet a i jeni referuar reagentit N-(1-Naphthyl)ethylenediaminedihydrochloride?! pasi në këtë rast duhet shtuar në specifikimet teknike x 2HCL dhe emërtimi N-(1-Naphthyl)ethylenediaminedihydrochloride!

Në shtojcën 5 të dokumenteve të tenderit është përcaktuar:

73	<i>MacConkey</i>	<i>Terren i lëngshëm për identifikimin e enterokokeve në uje dhe ushqim</i>	<i>kg</i>
----	------------------	-----------------------------------------------------------------------------	-----------

Është detyrë e Njesisë së Hartimit të Dokumentave të Tenderit hartimi i tyre në përputhje me LPP dhe RrPP duke dhënë informacion të saktë për operatorët ekonomikë. Duke qënë se tek specifikimet teknike përcaktohet terren i lëngshëm kurse njësia matëse është përcaktuar “kg” kërkojmë të sqarohet nëse terreni është pluhur apo i lëngshëm!?

Në shtojcën 5 të dokumenteve të tenderit është përcaktuar:

75	<i>Klimer agar</i>	<i>Terren diferencues për identifikimin e koliformeve në ujin e pijshëm</i>	<i>kg</i>
----	--------------------	-----------------------------------------------------------------------------	-----------

Është detyrë e Njesisë së Hartimit të Dokumentave të Tenderit hartimi i tyre në përputhje me LPP dhe RrPP duke dhënë informacion të saktë për operatorët ekonomikë. Duke qënë se një terren me këtë emërtesë dhe këto specifikime nuk ekziston kërkojmë të saktësohet emërtimi isaktë dhe specifikimet teknike të tij!

5. Kërkesë për ekspertizë të posacme

Po

Jo

(Nëse po, specifikoni llojin e ekspertizës që kërkon)

6. Kërkesë për përjashtim të zyrtarëve që do të merren me shqyrtimin e ankesës:

7. Lista e informacionit konfidencial:



Përcaktoni se cili informacion është konfidencial, nëse ka. Shpjegoni pse informacioni është ose një version i dokumenteve përkatëse me heqjen e pjesëve konfidenciale dhe një përmbledhje të përmbajtjes.

Kujdes :Ankimuesi duhet t'i bashkëlidhë ankimit, që do të paraqesë në autoritetin/ entin kontraktor dhe Komisionin e Prokurimit Publik, dokumentin bankar që vërteton pagesën e tarifës përkatëse për ankesën pranë Komisionit të Prokurimit Publik

Dërgojeni formularin e plotësuar të ankesës së prokurimit, të gjitha shtojcat e nevojshme dhe kopjet shtesë, pranë **Autoritetit /Enti Kontraktor dhe Komisionit te Prokurimit Publik.**

Shënim: Ankimuesi duhet ta dërgojë njëkohësisht ankesën në autoritetin/ entin kontraktor dhe Komisionin e Prokurimit publik

Nr. i faksit:

E-mail: avdulgjoni@yahoo.com

Nënshkrimi dhe vula e Ankuesit

Administratori/ Përfaqësuesi i autorizuar

Avdul Gjoni

